



Drejtuar: Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk

Adresa: Rr. Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, kthesa e Valiasit Nr. 1.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”, “Rikonstruksioni i rrugëve “Sabaudin Gabrani” dhe “Leka i Madh”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Rikonstruksioni i rrugëve “Sabaudin Gabrani” dhe “Leka i Madh”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-44439-11-21-2019

Fondi limit: 123,908,908 (njëqind e njëzetë e tre milion e nëntëqind e tetë mijë e nëntëqind e tetë) lekë pa TVSH.

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2019, miratuar me VKB Nr. 159, datë 21.12.2018 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2019 – 2021 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2019” (i ndryshuar), rialokuar me me VKB Nr. 157, datë 26.12.2019 “Për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2020 – 2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”.

Kohëzgjatja e kontratës: 9 (nëntë) muajve kalendarike duke nisur nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 23.12.2019, ora 10:00

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 47 datë 25.11.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk

NUIS K68121808W

Vlera e ofertës = **67,500,000** lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Glavenica” shpk & “Niem”& “Ed Konstruksion” shpk

NUIS K17710805A & NUIS K36609610Q & NUIS
K61625001I

Vlera e ofertës = **79,718,209** (shtatëdhjetë e nëntë milion e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntë) lekë pa TVSH.

3. Bashkimi i operatoreve ekonomike “Sireta 2 F” shpk & “Euroalb” shpk

NUIS K51501008J & NUIS K66613407H

Vlera e ofertës = **80,555,555** (tetëdhjetë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk

NUIS K81716011V

Vlera e ofertës = **81,286,352** (tetëdhjetë e një milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Almo Konstruksion” shpk &”Ulëza ndërtim” shpk

NUIS J91915001P & NUIS J67902928O

Vlera e ofertës = **81,722,498.03** (tetëdhjetë e një milion e shtatëqind e njëzetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë zero tre) lekë pa TVSH.

6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alesio 2014” shpk & “Alko Impex General Construction” dshh.

NUIS L41713003M& NUIS K91326028I

Vlera e ofertës = **83,134,839.06** (tetëdhjetë e tre milion e njëqind e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tridhjetë e nëntë pikë zero gjashtë) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk

NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = **83,355,833** (tetëdhjetë e tre milion e treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Liqeni VII” sha

NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **85,062,397** (tetëdhjetë e pesë milion e gjashtëdhjetë e dy mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

9. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biba X” shpk & “Senka” shpk

NUIS K32618815N& NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës = **87,569,277** (tetëdhjetë e shtatë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

10.Operatori ekonomik “Shpresa-AL” shpk

NUIS
K31321021N

Vlera e ofertës = **89,547,610** (tetëdhjetë e nëntë milion e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

11.Operatori ekonomik “Kthella” shpk

NUIS J69303023D

Vlera e ofertës = **90,671,482** (nëntëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

12.Operatori ekonomik “4-AM” shpk

NUIS
K92005016L

Vlera e ofertës = **92,928,353** (nëntëdhjetë e dy milion e nëntëqind e njëzetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

13.Operatori ekonomik “Bami” shpk

NUIS J94416206R

Vlera e ofertës = **95,353,139** (nëntëdhjetë e pesë milion e treqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

14. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk

NUIS K41416033P& NUIS J78311921L

Vlera e ofertës = **96,393,107.02** (nëntëdhjetë e gjashtë milion e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatë pikë zero dy) lekë pa TVSH.

15. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “V.A.S Konstruksion” shpk & “Llazo” shpk & “Adriatik” shpk

NUIS L61322023P& NUIS K24218401K& NUIS J61807505I

Vlera e ofertës = **98,027,821.19** (nëntëdhjetë e tetë milion e njëzetë e shtatë mijë e tetëqind e njëzetë e një pikë nëntëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

16. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bahas” shpk & ‘Avduli” shpk & “Elmazaj”

shpk

NUIS J61827083D& NUIS J66703306O& NUIS L33229401T

Vlera e ofertës = **100,441,934.38** (njëqind milion e katërqind e dyzetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH

17. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk

NUIS J62903508R& NUIS J61924002T

Vlera e ofertës = **102,827,645** (njëqind e dy milion e tetëqind e njëzetë e shtatë mijë e gjashtëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH

Janë s’kualifikuar ofertat e Operatorëve ekonomikë përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Shkëlqimi 07” shpk

NUIS K68121808W

- Operatori ekonomik ”Shkëlqimi 07” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, te përfshirë ne licensen e shoqërisë ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë...”* pasi inxhinieri i ndertimit profili transport nuk është përfshirë në Licensën e shoqërisë ndërsa Licensa personale rezulton në license në projektim dhe jo në zbatim.
- Operatori ekonomik ”Shkëlqimi 07” shpk nuk plotëson pikën 5 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, te përfshirë ne licensen e shoqërisë ose pajisur me license individuale, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë...”* pasi për Inxhinierin e Mjedisit nuk është paraqitur Libreza e Punës.
- Operatori ekonomik ”Shkëlqimi 07” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve, si më poshtë...”* pasi për punonjësit elektrikist, mekanik dhe hidraulik nuk janë paraqitur Diplomat përkatëse.

2. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem”& “Ed Konstruksion” shpk

NUIS K17710805A & NUIS K36609610Q & NUIS K61625001I

- Operatori ekonomik “Glavenica” shpk, pjese e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik ka paraqitur 4 kontrata ne ndertime te KUZ te cilat rezultojne qe nuk jane pune e

ngjashme me objektin e prokurimit konkretisht 1) Rehabilitimi në kanalet ujtesë sekondare të rezervarit Gjanç, 2) Ndërtim KUZ, fshati Strum, Bashkia Roskovec, 3) Ndërtim KUZ, fshati Strum, zona II, 4) Ndërtim I ujësjellsit Selenice, Pusi i Ri dhe Linja e dërgimit (dy pusët e rinj) Bashkia Selenice. Gjithashtu ka paraqitur 9 kontrata që rezultojnë si punë e ngjashme, shuma e të cilave në bazë të përqindjes të pjesëmarrjes 69%, nuk e përmbush vlerën e kërkuar për punën e ngjashme as për rastin kur kërkohej germa a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 61,954,454 (gjashtëdhjetë e një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit dhe as për rastin kur kërkohej germa b) punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 247,817,816 (dyqind e dyzetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë pa TVSH* çka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3 të Kapacitetve teknike, të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit kur kërkohej që: *Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben ofertën të kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtarët e bashkimit të cilët ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve....”* pasi për 3 elektrikistët e paraqitur mungojnë diplomat përkatëse.
- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve”* pasi 2 punonjës hidraulikë të deklaruar nga operatori ekonomik “Ed Konstruksion” shpk figurojnë me dëshmi të sigurimit teknik kategoria “I” ndërsa punonjësi hidraulik i deklaruar nga operatori ekonomik “Glavenica” shpk rezultoi pa diplomën përkatëse.
- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 8 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve”* pasi nga 3 punonjës mekanikë të paraqitur rezultojnë me mangësi dokumentacioni, konkretisht njëri figuron pa dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik dhe diplome përkatëse dhe tjetri pa diplomën përkatëse.
- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy)*

Eskavatorist, 2 (dy) Buldozerist, 2 (dy) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit” pasi është paraqitur dokumentacion për vetëm 1 nga 2 buldozeristë të kërkuar.

- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson gërmën ”e” të pikës 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”* pasi për mjetin Autobot uji me targë AA254SG është paraqitur foto ku nuk është e dukshme targa e mjetit dhe i gjithë dokumentacioni është paraqitur fotokopje pa vërtetimin e njëhësimin të kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”* ndërsa mjeti me targë AA359HV rezulton mjet i montuar kamion i certifikuar për transport mallrash+bot.
- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson gërmën ”a” të pikës 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes”* pasi për mjetin Autobetoniere me targë KO438OB nuk është paraqitur Çertifikata për transport mallrash brenda vëndit.
- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” shpk “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës/ Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5 ton deri në 5 ton”* pasi nga 2 kamioncina me kapacitet 3,5-5 ton të kërkuara, vetëm njëra plotëson kapacitetin ndërsa kamioncina me targë AA964E me kapacitet 1,1 ton, nën kapacitetin e kërkuar, kamioncina me targë KO0814B me kapacitet 6,3 ton, kamioncina me targë KO8086A me kapacitet 5,7 ton, kamioncina me targë AAA915PY me kapacitet 5,9 ton, pra mbi kapacitetin e kërkuar.
- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” shpk & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës/ Autobitumatrice”* pasi për mjetin me targë AA429FZ të deklaruar si Autobitumatrice nga verifikimi i dokumentacionit rezulton kamion për transport mallrash i marrë me qera sipas kontratës Nr. 5271. Rep, datë 21.11.2018. Bashkëlidhur saj është paraqitur një kontratë tjetër qeraje për marrjen me qera të impiantit të bitumit. Pra, është mjet i montuar.

- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson gërmën ”b” të pikës 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatëse (e vlefshme)”* pasi për mjetin Autobitumatrice me targë A429FZ nuk është paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshme.
- Bashkimi i operatoreve ekonomike “Glavenica” shpk & “Niem” & “Ed Konstruksion” shpk nuk plotëson gërmën ”b” të pikës 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatëse (e vlefshme)”* pasi për mjetin Autobitumatrice me targë AA125NY rezulton mjet i montuar dhe nuk është paraqitur Çertifikatë për transport mallrash të rrezikshme.

3. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomike “Sireta 2 F” shpk & “Euroalb” shpk

NUIS K51501008J & NUIS K66613407H

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Euroalb” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi mjetet: Kamioncinë me targa AA392CU, Autobitumatrice me targa AA548NX, Autobot uji me targa AA857VA rezultojnë të angazhuara në kontratën e nënshkruar me bashkinë Tiranë me objekt: *“ Rikonstruksioni I rruges Zall Bastar (Ura Zall Dajt deri ne Zall Bastar)- Loti II”* e cila nuk I ka përfunduar efektet ligjore-teknike-financiare.
- Operatori ekonomik “Euroalb” shpk nuk plotëson gërmën “h” të pikës 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor”* pasi nuk ka paraqitur deklaratë për vendndodhjen e mjeteve.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” shpk & “Euroalb” shpk nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nuk është deklaruar mjete i kërkuar “Autovinc”.

4. Oferta e paraqitur nga bashkimi i Operatoreve ekonomike “Alesio 2014” shpk & “Alko Impex General Construction” dshh

NUIS L41713003M& NUIS K91326028I

- Operatori ekonomik “Alesio 2014” shpk nuk plotëson pikën 3 të kapacitetit ekonomik dhe financiar të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Vërtetim për shlyerjen e taksave*

vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar” pasi Taksat lokale nga Bashkia Durres rezultojnë të shlyera deri në datë 31.12.2018.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alesio 2014” shpk & “Alko Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj nuk plotëson pikën 1 të kriterëve të vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën”* pasi pune e ngjashme e paraqitur nga operatori ekonomik “Alko Impex General Construction” dshh, kontrata me objekt: *“Sistemim Asfaltim i rruges Tale 1-Alk-Tale 2”*, nuk arrin vlerën e kërkuar, konkretisht rezulton **44,005,155** lekë pa tvsh nga **61,954,454** lekë pa tvsh e kërkuar sipas përqindjes së pjesëmarrjes në bashkimin ekonomik.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alesio 2014” shpk & “Alko Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj nuk plotëson gërmën ”e” të pikës17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”* pasi në foton e mjetit eskavator me targë AIMT10 nuk është e dukshme targa.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alesio 2014” shpk & “Alko Impex General Construction” degë e shoqërisë së huaj nuk plotëson pikën 17 të Kapacitetit Teknik, të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nuk është deklaruar në shtojcën 10 mjeti *“Makineri vijëzimi”*.

5. Oferta e paraqitur nga bashkimi i Operatoreve ekonomike “Biba X” shpk & “Senka” shpk

NUIS K32618815N& NUIS J94808405Q

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biba X” shpk & “Senka” shpk nuk plotësojnë pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme)...”* pasi për punonjësit mekanikë, hidraulikë dhe elektrikistë nuk janë paraqitur diplomat përkatëse.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biba X” shpk & “Senka” shpk nuk plotësojnë pikën 9 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) Eskavatorist, 1 (një) Buldozerist, 2 (dy) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit”* pasi nga 2 automakinistë të kërkuar, Xhelal Mosha i paraqitur nga operatori ekonomik “Biba X” shpk si automakinist nga verifikimi i dëshmisë së drejtimit figuron Buldozerist.
- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se dokumentacioni për kamioncinën me targë AA302LX është paraqitur fotokopje pa vërtetimin e noterizimit për njësisimin e

kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Dokumentat standarte të Tenderit: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.

- Operatori ekonomik “Senka” shpk nuk plotëson gërmën “h” të pikës 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor” pasi nuk ka paraqitur deklaratë për vendndodhjen e makinerive.
- Operatori ekonomik “Biba X” shpk nuk plotëson pikën 1 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “*Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën...*” pasi ka deklaruar si punë të ngjashme kontratën me objekt: “Rikonstruksion, sistemim e asfaltim sheshesh”. Vlera bazuar në situacionin përfundimtar është 61,235,667 lekë pa TVSH, e cila nuk përmbush vlerën e kërkuar sipas përqindjes së pjesëmarrjes në bashkim prej 61,954,454 lekë pa TVSH. Gjithashtu janë paraqitur situacioni 1-7, por nuk është paraqitur situacioni përfundimtar.

6. Oferta e paraqitur nga bashkimi i Operatoreve ekonomike “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk

NUIS K41416033P& NUIS J78311921L

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk përmbushin Kriteret e Përgjithshme të Dokumentave Standarte të Tenderit pasi të dy operatorët ekonomik nuk kanë paraqitur Shtojcën 12 sipas formatit të përcaktuar në DST.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: ” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi nuk janë deklaruar mjetet Vibrator thellësie, Rrul me kompresor, Matrapik, Makineri vijëzimi me bojë bikomponente.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: ” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi mjetin Autobitumatrice e ka paraqitur me faturë zhdoganimi dhe jo me dokumentacionin e kërkuar sipas gërmave “b” & “c” të kësaj pike.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: ” *Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)*” pasi nuk është paraqitur dokumentacion për kamioncinat e deklaruara.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: ”

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)” pasi është paraqitur dokumentacion vetëm për 1 kamion me kapacitet 10-15 ton nga 2 të kërkuar.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk plotësojnë pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve...”* pasi punonjësit e deklaruar nuk janë të pajisur me dokumentacionin e kërkuar: kontratë pune të vlefshme dhe diploma përkatëse.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk kanë deklaruar mjete dhe pajisje si: Tabela sigurie, prozhektorë, fikësë zjarri, kokore, komplet i ndihmës së shpejtë, makineri frezim asfalti, elektrosaldatrice, asfalto shtruese, vibrator, sipas faturave përkatëse por që nuk përmbush kërkesat e pikës 17 gërma e) *“Për mjete dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje...etj).*
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Kronos Konstruksion” shpk & “Everest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *” Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi Mjetet e deklaruara si: autobetoniere 2 (dy) copë, me targë AGMT 77 dhe AHMT88, Kamion 15 ton, me targë AA219 RP si dhe kamion 10 ton, me targë TR9708P, nuk janë të pajisura me Çertifikatë për transport mallrash brënda vendi.
- Gjithashtu folderat ku presupozohet të ketë dokumentacion për manovratorët, mjetet grejder dhe autobot uji rezultojnë të paaksesueshëm dhe pa asnjë dokumentacion. Duke qenë se oferta nuk rezulton e enkriptuar, ngarkimi I dokumentave në sistem është përgjegjësi e operatorit ekonomik, si dhe duhet te kryhet sipas udhëzimeve që Agjensia e Prokurimit Publik ka publikuar lidhur me ngarkimin e dokumentave dhe ruajtjen e tyre në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Oferta e paraqitur nga bashkimi i Operatoreve ekonomike “V.A.S Konstruksion” shpk & “Llazo” shpk & “Adriatik” shpk

**NUIS L61322023P& NUIS K24218401K& NUIS
J61807505I**

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “V.A.S Konstruksion” shpk & “Llazo” shpk & “Adriatik” shpk nuk plotësojnë pikën 1 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën.....”* pasi: Operatori ekonomik “Adriatik” shpk ne baze te perqindjes se pjesemarrjes ka marre persiper punime prishje, punime në trupin e rruges, punime trotuari, punime muri mbajtes, punime mure rrethuese, punime ne kanalizime KUB + KUZ, punime ne rrjetin e ujesjellesit, punime sinjalistike, punime ndricimi, punime gjelberimi dhe

urbane dhe për plotesimin e punes se ngjashme ka paraqitur kontraten me objekt: *“Furnizimi me uje ne rrugen Thoma Koxhaj”* e cila nuk eshte objekt i ngjashem me objektin e prokurimit. Ne kontraten e ngjashme të paraqitur nga operatori ekonomik “Llazo” shpk me objekt: *“Rikonstruksioni i rrugës Kel Kodheli.....”* lidhur me Bashkine Tiranë mungon Çertifikata e marrjes ne dorezim te punimeve. Ndërsa nga te gjitha kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik “Vas Konstruksion” shpk vetem nje nga kontratat eshte objekt i ngjashem me objektin e prokurimit perkatesisht kontrata lidhur me Autoritetin Kontraktor, Tirana Parking me objekt: *“Punime ndertimi i Shesh parkimi te Avni Rustemi”* e cila eshte ne vleren totale 6.586.982 leke me TVSH dhe sipas Koontratës së Bashkimit Ekonomik të operatorëve, referuar pjesëmarrjes në përqindje, operatori ekonomik “Vas Konstruksion” shpk merr persiper të realizojë 23 % te punimeve, pra e cila nuk permbush vleren e përkuar sipas këtij përfaqësimi dhe sipas Dokumentave Standarte të Tenderit, konkretisht perkatesisht 14.249.524 lekë.

- Operatori ekonomik “V.A.S Konstruksion” shpk nuk plotëson pikën 4 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Një punësim mesatar i të paktën 60 (gjashtëdhjetë) personave, për periudhën Tetor 2018 - Tetor 2019 të vërtetuar me.....”* pasi referuar numrit mesatar të punonjësve dhe numrit të punonjësve të anagazhuar në kontratat e nënshkruara me Bashkinë Tiranë, konkretisht me objekt: *“Ndërtimi i rrugës që lidh rrugën ”Tish Daia” me rrugën ”Robert Shvarc” dhe “Ndërtimi i segmentit rrugor nga rreth-rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha”* rezulton një numër i pamjaftueshëm punonjësish për procedurën objekt prokurimi.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “V.A.S Konstruksion” shpk & “Llazo” shpk & “Adriatik” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“ Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)”* pasi për mjetin autobitumatricen me targë AA572FL nuk eshte paraqitur Çertifikata për transport mallrash të rrezikshme.

8. Oferta e paraqitur nga bashkimi i Operatoreve ekonomike “Bahas” shpk & “Avduli” shpk & “Elmazaj” shpk

NUIS J61827083D& NUIS J66703306O& NUIS
L33229401T

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bahas” shpk & ‘Avduli” shpk & “Elmazaj” shpk nuk plotësojnë pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“ Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, librezë pune dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm...”* pasi operatori ekonomik ”Elmazaj” shpk nuk ka paraqitur libeze pune per mjekun ndersa diploma dhe urdheri i mjekut jane paraqitur fotokopje pa vertetimin e noterizimit te njehsimit te kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me kushtin e paraqitur në DST: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të*

dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bahas” shpk & ‘Avduli” shpk & “Elmazaj” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nga 2 kamioncina me kapacitet mbajtës 3,5-5 ton të kërkuara, vetëm 1 plotëson kapacitetin. Kamioncina me targe AA709CG me kapacitet 1 ton, kamioncina me targe AA967DT me kapacitet 3,46 ton dhe pa Çertifikatë Pronësie dhe kamioncina me targe TR5429I me kapacitet 2,1 ton, pra nën kapacitetin e kërkuar.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bahas” shpk & ‘Avduli” shpk & “Elmazaj” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi për mjetet Autobot Uji me targë AA921EZ dhe AA386FK nuk janë paraqitur Çertifikatat e Pronësisë.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bahas” shpk & ‘Avduli” shpk & “Elmazaj” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nga 2 eskavatorë me goma te kerkuar nuk eshte deklaruar asnje eska vator me goma por eskavator me zinxhire.

9. Oferta e paraqitur nga bashkimi i Operatoreve ekonomike “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk

NUIS J62903508R& NUIS J61924002T

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk nuk plotësojnë pikën 1 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën...”* pasi Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk ka paraqitur kontratë si punë të ngjashme me objekt të ndryshëm nga ai që prokurohet konkretisht: “Rehabilitimi i linjës së furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytetin Sarandës, Shqipëri”.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk nuk plotësojnë pikën 5 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt ...”* pasi për inxhinierin e ndërtimit profili transport diploma është paraqitur fotokopje pa vërtetim noterizimi të njësisimit të kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.*
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk nuk plotësojnë pikën 8 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi*

kualifikimi e sigurimit teknik ...” pasi Nga 2 mekanikë të kërkuar rezulton se: Operatori ekonomik “B 93” ka paraqitur mekanikun Danjel Hoxha me kontratë në datën 16.12.2019 pra nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për për 6 (gjashtë) muajt e fundit ndërsa mekaniku I paraqitur nga operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk rezulton pa dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk nuk plotësojnë pikën 9 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: ” Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) Eskavatorist, 2 (dy) Buldozerist, 2 (dy) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme)...” pasi Punonuesit buldozeristë të paraqitur nga operatori ekonomik “ B 93” shpk rezultojnë me kontratë pune datë 16.12.2019, pra nuk figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 6 (gjashtë) muajt e fundit.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Bahas” shpk & ‘Avduli” shpk & “Elmazaj” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nga 2 kamioncina me kapacitet mbajtës 3,5-5 ton vetëm 1 plotëson kapacitetin. Kamioncina me targe AA709CG me kapacitet 1 ton, kamioncina me targe AA967DT me kapacitet 3,46 ton dhe kamioncina me targe TR5429I me kapacitet 2,1 ton.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi asnjë nga kamionët e deklaruar nuk plotësojnë kapacitetin mbajtës të kërkuar 10-15 ton.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi nga 2 kamioncina me kapacitet 3,5-5 ton vetëm njëra ka dokumentacion të rregullt. Kamioncina me targë AA580MD mbi kapacitet; 5,4 ton dhe për kamioncinë me targë AA976BA I gjithë dokumentacioni është paraqitur fotokopje pa vërtetimin e noterizimit për njëhësimin e kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”*.
- Bashkimi i operatorëve ekonomikë “B-93” shpk & “Shansi Invest” shpk nuk plotësojnë pikën 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *”Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pasi Për mjetin Autobitumatrice me targë AA830LT certifika e pronësisë, leja e

qarkullimit, certifikata për transport mallrash të rrezikshme janë paraqitur fotokopje cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”*. Gjithashtu në foto nuk është e dukshme targa e mjetit në kundërshtim me gërmën “e” të pikës 17 të kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: “bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”*”.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatori ekonomik “Company Riviera 2008” shpk**, me adresë: **Rr. Nacionale Kamëz-Fushë Krujë, kthesa e Valiasit Nr. 1**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **81,286,352 (tetëdhjetë e një milion e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e dy)** lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **81,722,498.03 (tetëdhjetë e një milion e shtatëqind e njëzetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë zero tre)** lekë pa tvsh, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar).

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 30.01.2020.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.